



REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep. <u>03-02/DPK</u>	Br.Prot. <u>01-1313/16</u>
Nr. I faq.	Data
Broj stranica <u>09</u>	Datum <u>31-03-2016</u>
Nr. pages	Date
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 (paragrafi 11 dhe 12) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 31.03.2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-02-2787/15, për z. Nenad Radosavljevic – Këshilltar Komunal në Komunën e Leposaviqit, për shkak se ai ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK – 03-02-2787/15, për z. Nenad Radosavljevic – Këshilltar Komunal në Komunën e Leposaviqit, dhe njëkohësisht pronar në bizneset private “Nezavisna Tv Mreza” dhe “Radio Televizija Mir”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Fillimisht, zyrtari i lartë është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, pas së cilës ai është takuar me zyrtarët e AKK-së.

z. Radosavljevic është njoftuar se nuk mund të ushtroj në mënyrë aktive të drejtën e pronësisë në biznese private, krahas funksionit publik të zyrtarit të lartë si dhe për ndryshimet që duhet të bëj, për të shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik. Ai ka premtuar se do të shmang konfliktin e interesit duke caktuar person të autorizuar për të administruar bizneset e tij.

Ndërkohë ka dërguar në Agjenci shkresat zyrtare, të lëshuara nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, me të cilat vërtetohet se ka caktuar personat e autorizuar për të menaxhuar bizneset e tij private. Me këtë zyrtari i lartë ka shmangur situatën e konfliktit të interesit në të cilin ndodhej.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

U skladu sa članom 11.(stav1.1), članom 5(stav 1, tačka 1.5), članom 18(stav 10 i 11) Zakona br.03/L-159 za Agenciju protiv Korupcije, kao i sa članom 24 (stav 11 i 12) Pravilnika o Radu Agencije protiv Korupcije,br.01/2014, Direktor Agencije protiv Korupcije, dana 31.03.2016, doneo je sledeću:

O D L U K U

- I. Zatvara se slučaj broj AKK – 03-02-2787/15 za g.Nenad Radosavljević, Opštinski Savetnik u Opštini Leposavić, zato što je on izbegao situaciju sukoba interesa u kojoj je bio.**
- II. Slučaj se može obnoviti u svako doba ukoliko se pojavljuju nove okolnosti.**

O b r a z l o ž e n j e

I. Pokrenuti slučaj pod osnovanom sumnjom za Sukob Interesa u Vršnju Javne Funkcije, br. AKK – 03-02-2787/15 za g.Nenad Radosavljević, Opštinski Savetnik u Opštini Leposavić,, i istovremeno vlasnik u privatnom biznisu “Nezavisna Tv Mreža” i “Radio Televizija Mir”, je tretiran prema predviđenoj proceduri po Zakonu br.04/L-051 za sprečavanje sukoba interesa u toku vršenja javne funkcije.

g.Radosavljeviću je prvo upućeno službeno pismo sa obaveštenjem o pokretanju procedure razmatranja mogućeg stanja sukoba interesa , nakon čega je on kontaktirao službenike APK.

g.Radosavljević je upoznat sa time da ne može vršiti funkciju aktivnog vlasnika u privatnom biznisu, uporedo sa funkcijom visokog javnog zvaničnika I izmenama koje treba učiniti da bi izbegao stanje sukoba interesa, dok je on obećao da će u najkraćem roku otkloniti sukob interesa time što će ovlastiti poverljivo lice za vođenje privatnog biznisa , da bi nastavio sa obavljanjem javne funkcije .

U međuvremenu, isti je Agenciji protiv Korupcije dostavio službeno pismo od strane Agencije za Registraciju Biznisa na Kosovu kojim se potvrđuje da je on ovlastio lice za menadžiranje privatnih biznisa “Nezavisna Tv Mreža” i “Radio Televizija Mir”.Ovime je visoki zvaničnik izbegao stanje sukoba interesa u kojem se nalazio.

Stoga je odlučeno kao u dispozitivu ovog rešenja.

II. Uskladu sa članom 18(stav11) Zakona br.03/L-159 za Agenciju protiv Korupcije, Agencija može u svako doba obnoviti slučaj kada se pojavljuju nove okolnosti, pa je odlučeno kao u dispozitivu ovog rešenja .

Odluka se dostavlja:

- visokom javnom zvaničniku
- direktoru DSK
- odgovornom službeniku

Direktor Agencije protiv Korupcije:

Hasan Preteni

